



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **26.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal e caktuar me vendimin Nr. 138, datë 22.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personave nën hetim **Xhino Roka, Klaus Matishi (alias Klaus Çopja alias Kledjan Çopja), Marsel Roka, Skender Sufaj, Artan Hoxha, Elton Qyno, Pajtime Fetah, Dedan Gjoni, Blerina Beqiri**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 234, 237, 238 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 146, datë 27.11.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale e caktuar me vendimin Nr. 138, datë 22.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personave nën hetim: **Dedan Gjoni, Pajtime Fetah, Skënder Sufaj, Klaus Matishi (alias Klaus Çopja alias Kledjan Çopja), Xhino Roka dhe Marsel Roka** si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
2. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personat nën hetim **Dedan Gjoni, Pajtime Fetah, Skënder Sufaj, Klaus Matishi (alias Klaus Çopja alias Kledjan Çopja), Xhino Roka dhe Marsel Roka**, të dërgohen menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
3. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale e caktuar ndaj personit nën hetim **Blerina Beqiri** me vendimin Nr. 138, datë 22.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si e dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 319 – 25 i K.Penal, me masën e sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*” e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
4. Personi nën hetim **Blerina Beqiri** detyrohet të paraqitet ne Zyrat e Policisë Gjyqësore, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar të hënën e parë të çdo muaji në orën 11:00.

5. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore” e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale e caktuar me vendimin Nr. 138, datë 22.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personave nën hetim: **Artan Hoxha** dhe **Elton Qyno** si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
6. Personi nën hetim **Artan Hoxha** detyrohet të paraqitet në Zyrat e Policisë Gjyqësore, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të hënën e parë të çdo muaji në orën 13.00.
7. Personi nën hetim **Elton Qyno** detyrohet të paraqitet në Zyrat e Policisë Gjyqësore, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të martën e parë të çdo muaji në orën 13.00.
8. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, dhe policia gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
9. Mbrojtësit e caktuar kryesisht nga gjykata për personat nën hetim të shpërblehen nga shteti sipas tarifave të parashikuara në ligj.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar brënda 5 ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 27.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar